



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. ....<sup>33</sup>..... Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 21 / 02 / 2023

**VENDIM**

Nr.06, date 21 /02/2023

**PËR**

**RREGULLOREN E SHFRYTEZIMIT, OPERIMIT, MIREMBAJTJES, MONITORIMIT DHE SIGURISE SE DIGES SE HEC LUMZI**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 21.02.2023 mori në shqyrtim Rregulloren e shfrytëzimit, operimit, monitorimit dhe sigurisë së digës së HEC Lumzi të paraqitur nga Shoqëria MC Inerte Lumzi shpk.

Dokumentacioni i kësaj rregulloreje të dorëzuar pranë SKDM ka përfshirë kërkesat e udhëzimit të KKDM në lidhje me hartimin e këtyre rregulloreve të shprehura në Vendimin e KKDM Nr. 3, dt.19.10.2020. KTPD i rekomandoi antareve të KKDM të miratoj rregulloren për shfrytëzimin e digës së HEC Lumzi duke patur parasysh që në këtë rregullore të përditesohet rregullorja e shkarkimit të plotave duke përfshirë edhe prurjet e mëdha që vijnë një herë në 100 vjet dhe një herë në 50 vjet. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

**VENDOSI:**

- 1- Të miratoj Rregulloren e Shfrytëzimit, Operimit, Mirembajtjes, Monitorimit dhe Sigurisë së digës së HEC Lumzi të paraqitur nga Shoqëria MC Inerte Lumzi shpk.
- 2- Ti kërkoj shoqërisë MC Inerte Lumzi shpk:
  - Instalimin e sistemeve të monitorimit Hidrometeorologjik, sizmik dhe hidrogjeologjik (Piezometra) në trupin e digës dhe dërgimin pranë KKDM të skemave dhe planimetrive të vendosjes së sistemeve të monitorimit të digës
  - Dorëzimin pranë KKDM të të dhënave të matjeve të monitorimit gjeodezik, lëvizjeve të mundshme në digë dhe niveleve të ujërave nentokesore të matura në piezometrat e instaluar.
  - Përgatitjen e hartave të përmbajtjeve duke u bazuar në llogaritjet e valës vërsuese dhe prurjeve maksimale të mundshme. Këto harta duhet të japin të paktën thellësinë maksimale të ujit, shpejtësinë e levizjes, sipërfaqen e hartës dhe numrin e njerëzve në rrezik duke u bazuar në rezultatet e llogaritjeve hidraulike të valës vërsuese
  - Përditesimin e rregullores së shkarkimit të plotave të mëdha duke përfshirë edhe shkarkimet për shkakt të prurjeve të mëdha që vijnë një herë në 50 vjet dhe një herë në 100 vjet. Për këto raste, kompania MC Inerte Lumzi shpk duhet të parashikoj informimin e institucioneve përkatëse duke përfshirë pushtetin lokal, prefekturën, AKMC dhe KKDM në kohë reale dhe përpara hapjes së portave të shkarkimit;

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë Vendim sipas legjislacionit në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

**KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA**

**KRYETARI**

**Arjan JOVANI**

